

LIGJ
Nr.9916, datë 12.5.2008

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.9723, DATË 3.5.2007 “PËR QENDRËN
KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, pas nenit 5 shtohet neni 5/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 5/1

Sportelet në dhomat e tregtisë dhe industrisë

1. QKR-ja ofron shërbimin ndaj publikut edhe nëpërmjet sporteleve në Bashkimin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë dhe në dhomat e tregtisë dhe industrisë në qarqe, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Të gjitha shpenzimet për hapjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e sporteleve mbulohen nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë dhe dhomat e tregtisë dhe industrisë në qarqe.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5740, datë 26.5.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi